

**VENDIM**  
**Nr. 687, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 206, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË STACIONIT TË ZJARRFIKËSES DHE TË**  
**GODINËS SË BORDIT TË KULLIMIT, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E**  
**BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 206, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në masën 168 314 290 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e treqind e katërmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 62 340 125 (gjashtëdhjetë e dy milionë e treqind e dyzet mijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 105 974 165 (njëqind e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**